

## NË KUJTIM TË ATDHETARIT QË PROJEKTOJ PAMVARSINË E ATDHEUT...



NGA **PJETER LOGORECI** Faqe 21

Ai vazhdon të shihet përsëri me skepticizëm, pasi asnjë personalitet i lartë nuk ka shkuar për të vendosur një kurorë me lule apo të bëjë homazhe nderi pranë varrit të këtij burrë të madh...

## ROLI DHE TË DREJTAT E GRUAS NË SHQIPËRINË E SHEK. XVII-XVIII



Dokumentat arkivore tregojnë që gruaja shqiptare gëzonte disa të drejta themelore si e drejta e të trashëguarit, e fejesës dhe martesës, e drejta e pasurisë dhe e menaxhimit të saj, të drejtën e aplikimit në gjykata për të drejtat e saj etj...

NGA **EDUART ÇAKA**

Faqe 20-21

# RILINDASI

Suplement i SHQIPTARJA.com

E diel

8 maj 2016

Viti VI - Nr:17

e-mail: rilindasi@gmail.com

Kryeredaktore;  
Admirina Peçi



**Ngjyrat origjinale të Artistit/** Tek ai lindi miti, la gjurmë pasioni dhe shndritën ndjenjat

## TANO BANUSHI

**Në rol edhe mustaku duhet me folë, dhe pantalloni, edhe kasketa e vume mënjanë...**

NGA **XHAHID BUSHATI**

## ANDREA SKANJETI, "ZEMËR NANE", TREGIM I SHKRUAR NË VITIN 1938, SHKODËR

NGA **ANDREA SKANJETI** Faqe 16-17

Gjithçka kishte krye. Nanë mjerën, kur erdhi koha ta marrin te vdekunin, mëzi e shkëputën nga trupi i tij. Gjergji në pushimin e mbramë u përçoll me nderime të mëdha. Nata po binte në shtëpinë në jazë si rrasa e randë bie mbi vorr...



**H**erë pas here, edhe pse i distancuar në kohë, i jam kthyer figurës poliedrike të Tano Banushit, të cilin kam pasur fatin ta njoh e ta ndjek për shumë vite në skenë. Një aktor brilant, i papërsëritshëm i humorit shqiptar. Një lexues i rregullt, veçanërisht, i letërsisë humoristike. Një artist, përgjithësisht i një natyre të heshtur, por që kërkonte... sa në skenë e sa në letërsi. Mbase donte të plotësonte diçka që i mungonte, të cilën ai nuk e thoshte asnjëherë, të cilën nuk e shfaqte... E, ai Tanoja i çdoditshëm ishte një kërkues... Dontë të plotësohej kulturalisht.

Gjithmonë me mendimin se kam lënë diçka mangut pa thënë, e pse jo, më duket sikur vitet dhe koha ende dinë diçka (në të vërtetë dinë

shumëçka) dhe ma fshehin... Sepse, në të vërtetë, universi aktorek i Tano Banushit, ka bërë që në skenën e estradës... (më vjen në ndihmë fraza e një studiuesi, të cilën dua ta përfrazoj) ... aty (të) lind miti, aty (të) lë (rë) gjurmë pasioni, aty (të) shndrisin ndjenjat.

Gjithmonë kam menduar, se ku qëndron sekret i këtij aktori kaq brilant në fushën e humorit? Mendoj, tek origjinaliteti. Original në të folur, në të interpretuar, në jetën e përditshme.

VIJON NË FAQEN

14-15

## 99 VJETORI | I VDEKJES



► Sjellja e eshtrave të Imzot Nikollë Kacorri në shqipëri

# Imzot Nikollë Kacorri

## Në kujtim të atdhetarit që projektoj pamvarsinë e atdheut...

NGA **PJETER LOGORECI**

Sa herë që afrohen përvjetore apo data jubilarë të jetës apo aktivitetit të Imzot Nikollë Kacorrit, më vjen natyrshëm dëshira për ta kujtuar këtë burrë të madh të pamvarsisë së atdheut, në mënyrë të ndryshme, me foto, dokumenta mbi jetën e aktivitetin e tij, ngjarje të ndryshme apo thënie e kujtime të atyre që e njohën nga afër. Këtë vit, me 29 maj, është 99-vjetori i vdekjes së tij në Vjenë të Austrisë dhe dëshiroj të publikoj një fotografi të marrë nga fondi fotografik i fototekës Marubi në Shkoder, një foto që flet shumë historikisht dhe që do të kënaq familjarët e dashamirët e arkitektit të pamvarsisë, Imzot Kacorrit.

Sic dihet nga shkrimet e hershme, Imzot Kacorri kishte lidhje miqësore me familjen e famëshme të Marubve, e falë natyrës së tij komunikuese dhe sociale, ai mbante kontakte të ngushta edhe me shumë figura të njohura të politikës, fesë, diplomacisë apo ato ushtarake. Në këtë shkrim po paraqes një foto të pabotuar më parë, ku Imzot Kacorri shihet përkrah kolosit tjetër të atdhetarisë, Imzot Luigj Bucit. Fotoja është fiksuar në studio nga Kel Marubi, por nuk ka shënim një datë egzakite.

Me sa shihet, kjo foto duhet të jetë e periudhës kur kleriku Don Luigj Bumci është shuguruar ipeshkëv i Lezhës, në dhjetor 1911. Të dy klerikët ishin e shumë aktiv në bisedimet për marrëveshjen në mes malësorve dhe qeverisë turke. Imzot Kacorri si përfaqësues i Arqipeshkvit Bardhi dhe Imzot Bumci anëtar i komisionit që kryesonte Imzot Serreqi.

Në një referencë të po këtij viti, që konsulli i përgjithshëm Zambaur, nga Shkodra, i drejton ministrisë së jashtme në Vjenë, për Imzot Bumcin shkruan këto fjalë:....."Kooperatori (ndihmësi)

**Ai vazhdon të shihet përsëri me skepticizëm, pasi asnjë personalitet i lartë nuk ka shkuar për të vendosur një kurorë me lule apo të bëjë homazhe nderi pranë varrit të këtij burrë të madh...**

Don Luigj Bumci është një burrë inteligjent, me personalitet të fortë, i durueshëm e i qetë, i cili në lidhje me postin që merr (Ipeshkëv), ka një aftësi të shprehurit, të vepruarit shumë të respektueshme, prandaj është shumë popullor dhe e duan të gjithë...

Me 10 dhjetor 1911, në katedralen e Shkodrës, u bë shugurimi i tij dhe i Imzot Kolecit si ipeshkëv të Lezhës dhe Sapës, në praninë e klerikëve të lartë, popullit të Shkodrës, të Valisë, personelit të Konsullatave dhe Konsullit Zambaur....

Në realitet, Imzot Kacorri ka lindur në vitin 1862 ndërsa Imzot Bumci në 1872-shin dhe kanë 10 vite diferencë. Sic mund të shihet edhe në foto, është përafërsisht në moshën 38 vjecare, kur don Luigj Bumci, është shuguruar ipeshkëv. Edhe Imzot Bumci ashtu si Imzot Kacorri, ka një biografi të pasur me aktivitetë në të mirë të atdheut e shqiptarve. Ai ka qënë autor i disa memorandumëve për autonominë e Shqipërisë, po ashtu në krah të Gurakuqit, punoj për të organizuar malësorët në kryengritje kundër pushtuesve. Nga përkushtimi



i tij për atdheun, personalitetet e kohës e zgjidhën kryetar të përfaqësues së shqiptarve në Konferencën e Paqës në Paris (ku pat sekretar Fishter). Me tagrin e klerikut, por i shtyrë nga atdheadashuria ai ndërhyri me forcë në Vatikan, pranë Papa Benediktit të XV, që Korca dhe Gjirokastra të mos i shkëputeshin Shqipërisë (sipas paktit djallezor, Itali – Greqi, ose sic quhet, marrëveshja Tittoni – Venizelos). Mori pjesë në Kongresin e Durrësit ku u zgjodh anëtar i qeverisë së Turhan Pashës, si ministër pa portofol, ndërsa anëtar i Rregjencës, u zgjodh si përfaqësues i komunitetit katolik shqiptar, në Kongresin e Lushnjës. Si shumë burra të mëdhenj shqiptar, për ti shpëtuar pëmdjekjes së politikës së kohës, ju desht të mërgonte në vitin 1922 deri 1924-shin. Vdes nga dhuna e komunistave dhe sigurimit të shtetit në kuvendin e fretërve në Troshan me 1 mars 1945 dhe u varros në kishën e Kallmetit.

Ndërsa, Imzot Kacorri, kreu të njëjtën shkollë fillore në fillimet e

tij si klerik dhe me vonë mori pjesë aktive në organizimin e malësorve në kryengritjet e Kurbinit. Arkitekti i pamvarsisë Nikollë Kacorri, mori pjesë në Kongresin e Manastirit 1908, si dhe atë të Elbasanit 1909. U aktivizua në krah të Isamil Qemalit në shpalljen e pamvarsisë së vendit, duke marrë përsipër rolin e zëvendës kryeministrit në qeverinë e parë historike shqiptare. Ashtu si Bumci edhe Imzot Kacorri, i përndjekur nga forcat e errëta të kohës, u detyrua të largohet nga Shqipëria dhe të jetoj në Austri, ku pas tre viteve vdiq.

Ai nuk arriti (si Bumci) të njohë komunizmin, por figura e tij e njohu diskriminimin komunist që u distancua ndaj tij, si klerik. Edhe në ditët e sotme, vazhdon përsëri mungesa e vlerësimit për figurën e Imzot Kacorrit, për të cilin nuk u organizua asnjë pritje zyrtare me rastin e ardhjes së eshtrave të tij nga Vjena. Nuk egziston akoma sot një shtatore, që të jetë e vendosur në një vend qendror, sic ai për aktivitetin e tij e meriton. Vazhdohet gabimisht të shihet si prift katolik edhe pse aktiviteti i tij ishte në të mirë të pamvarsisë së vendit.

Dy vjet më parë, personalisht fillova të interesohem dhe të kontaktoj me personalitete apo nëpunës të lartë të shtetit shqiptar, që të organozonej një vizitë zyrtare e qeveritarëve, ditën e festes kombetare, tek varrit ku ndodhen eshtrat e kolosit të lirise e të pamvarsisë, në Durrës. Sic duket, ai vazhdon të shihet përsëri me skepticizëm, pasi asnjë personalitet i lartë nuk ka shkuar për të vendosur një kurorë me lule apo të bëjë homazhe nderi pranë varrit të këtij burrë të madh.

Si rrjedhojë, dëshëroj ti bëj thirrje politikës shqiptare, që ta shohe me objektivitet këtë problem dhe të vlerësojë sic i takon figurën madhështore të Imzot Nikollë Kacorrit, i cili u sakrifikua për atdheun me motivacionin:..... më parë Atdheu .... pastaj Feja.

Vjena, me 1maj 2016